

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 28

## Investime në Pjesëmarrje

### Objekti

1 Ky Standard duhet të zbatohet në kontabilitetin e investimeve në pjesëmarrje. Megjithatë standardi nuk zbatohet për investimet në pjesëmarrje të zotëruara nga:

- a) organizatat kapitale sipërmarrëse, ose
- b) fondet e përbashkëta, njësitë e besimit dhe njësi ekonomike të ngjashme, duke përfshirë këtu fondet e sigurimeve të lidhura me investimin.

të cilat pas njohjes fillestare përcaktohen si të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes ose janë klasifikuar si të mbajtura për tregtim dhe që kontabilizohen në përputhje me SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*. Këto investime do të maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39, me njohjen e ndryshimeve në vlerën e drejtë në fitimin ose humbjen në periudhën e ndodhjes së ndryshimit.

### Përkufizime

2 Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:

*Një Pjesëmarrje* është një njësi ekonomike, duke përfshirë edhe njësi ekonomike jo-me kapital të bashkuar, si për shembull një ortakëri, mbi të cilën investori ka influencë domethënëse dhe e cila nuk është as filial dhe as një interes kapitali në një sipërmarrje të përbashkët.

*Pasqyrat financiare të konsoliduara* janë pasqyrat financiare të një grupi të paraqitura si pasqyrat financiare të një njësie të vetme ekonomike.

*Kontroll* është fuqia për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të merren përfitime nga aktivitetet e saj.

*Metoda e kapitalit neto* është një metodë e kontabilitetit sipas të cilës investimi njihet fillimisht me kosto dhe rregullohet më pas për ndryshimin pas blerjes të pjesës që i përket investorit në aktivet neto të investuarit. Fitimi ose humbja e investitorit përfshin pjesën që i takon atij në fitimin ose humbjen e të investuarit.

*Kontroll i përbashkët* është marrëveshja kontraktuale për të ndarë kontrollin mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm atëherë kur për marrjen e vendimeve strategjike financiare dhe operationale në lidhje me aktivitetin kërkohet miratimi unanimitet i palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

*Pasqyrat financiare individuale* janë pasqyrat financiare që paraqiten nga një shoqëri mëmë, një investitor në një pjesëmarrje ose një sipërmarrës në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht, në të cilat investimet janë llogaritur në bazë të interesit direkt të kapitalit neto dhe jo mbi bazën e rezultateve të raportuara dhe të aktiveve neto të njësisë ku është investuar.

*Influencë domethënëse* është fuqia për të marrë pjesë në vendimet për politikat financiare dhe operuese të investuarit por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

*Një filial* është një njësi ekonomike, duke përfshirë dhe një njësi ekonomike jo me kapital të bashkuar, si për shembull një ortakëri, e cila kontrollohet nga një njësi tjetër ekonomike (të njohur si shoqëria mëmë).

3 Pasqyrat financiare në të cilat aplikohet metoda e kapitalit neto nuk janë pasqyra financiare individuale dhe as pasqyra financiare të një njësie ekonomike e cila nuk zoteron ndonjë filial, pjesëmarrje ose interes sipërmarrësi në një sipërmarrje të përbashkët.

4 Pasqyrat financiare individuale janë ato pasqyra të cilat paraqiten në shtesë dhe bashkë me pasqyrat financiare të konsoliduara, pasqyra financiare në të cilat investimet kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto dhe me pasqyrat financiare ku interesat e sipërmarrësve në sipërmarrjet e përbashkëta konsolidohen proporcionalisht. Pasqyrat financiare individuale mundet ose jo t'u bashkangjiten apo të shoqërojnë pasqyra financiare të konsoliduara.

5 Njësitë ekonomike të cilat përjashtohen nga konsolidimi në përputhje me paragrafin 10 të SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale*, nga aplikimi i konsolidimit proporcional në përputhje me paragrafin 2 të SNK 31 *Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta* ose nga aplikimi i metodës së kapitalit neto në përputhje

me paragrafin 13 (c) te ketij Standardi, mund të paraqesin pasqyra financiare individuale si të vetme pasqyra financiare të tyre.

## **Influenca domethënëse**

- 6 Nëse një investitor zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte (p.sh. nepërmjet filialeve), 20 përqind ose më shumë të fuqisë votuese të të investuarit, supozohet që investitori ka influencë domethënëse, me përjashtim të rastit kur mund të tregohet qartësisht që kjo nuk është e vertetë. Në të kundërtën, nëse investitori zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte (p.sh. nepërmjet filialeve), me pak se 20 përqind të fuqisë votuese të të investuarit, supozohet se investitori nuk ka influencë të konsiderueshme, me përjashtim të rastit kur një influencë e tillë mund të tregohet qartësisht. Një zotërim thelbësor apo i maxhorancës i pronësisë nga një investitor tjetër nuk e ndalon medoemos një investitor të ketë influencë domethënëse.
- 7 Ekzistenca e influencës domethënëse nga një investitor zakonisht evidencohet në një ose më shumë nga mënyrat që vijojnë:
- (a) përfaqesim në bordin e drejtorëve ose organin drejtues ekuivalent të të investuarit;
  - (b) pjesëmarrje në proceset e bërjes së politikave, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendim-marrjen mbi dividendët apo shpërndarjet e tjera;
  - (c) transaksione materiale midis investorit dhe të investuarit;
  - (d) shkëmbim i personelit drejtues; ose
  - (e) dhënia e informacionit thelbësor teknik.
- 8 Një njësi ekonomike mund të ketë në pronësi garanci aksionesh, opsjon blerje aksionesh, instrumente borxhi apo kapitali të cilat janë të konvertueshme në aksione të zakonshme, ose instrumente të tjera të ngjashme të cilat kane mundësinë, nëse përdoren ose konvertohen, që t'i japin njësisë ekonomike me tepër fuqi votuese ose të zvogëlojnë fuqinë votuese të një pale tjetër mbi politikën financiare dhe operative të një njësie ekonomike tjetër (të drejta votuese potenciale). Kur vlerësohet nëse një njësi ekonomike ka influencë domethënëse merren në konsideratë ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale të cilat janë aktualisht të përdorshme ose të konvertueshme, duke përfshirë të drejtat votuese potenciale të zotëruara nga njësi të tjera ekonomike. Të drejtat votuese potenciale nuk jane aktualisht te përdorshme ose të konvertueshme, kur, për shembull, ato nuk mund të përdoren ose konvertohen deri në një datë të ardhshme ose deri pas ndodhjes së një ngjarjeje të ardhshme.
- 9 Kur vlerësohet nëse te drejtat votuese potenciale kontribuojne në influencen domethënëse, njësia ekonomike shqyrton të gjitha faktet dhe rrethanat (duke përfshirë kushtet e përdorimit të të drejtave votuese potenciale dhe të të gjitha marreveshjeve të tjera kontraktuale, qofshin këto të konsideruara individualisht apo së bashku), të cilat kane efekt në të drejtat votuese potenciale, me përjashtim të qëllimit të drejtimit dhe aftësinë financiare për të përdorur apo konvertuar këto të drejta.
- 10 Një njesi ekonomike humbet influencën domethënëse mbi një të investuar kur ajo humbet fuqinë për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të të investuarit. Humbja e influencës domethënëse mund të ndodhë me ose pa një ndryshim në nivelet absolute apo relative te pronësisë. Kjo mund të ndodhë, për shembull, kur një pjesëmarrje bëhet subjekt i kontrollit të qeverisë, gjykatës, administratorit apo rregullatorit. Kjo mund të ndodhë gjithashtu edhe si rezultat i ndonjë marrëveshjeje kontraktuale.

## **Metoda e Kapitalit Neto**

- 11 Sipas metodës së kapitalit neto, investimi në një pjesëmarrje njihet fillimisht me kosto dhe vlera kontabël rritet ose zvogëlohet për të njohur pjesën e investitorit në fitimet apo humbjet e të investuarit pas datës së blerjes. Pjesa e investitorit në fitimet ose humbjet e të investuarit njihet në fitimin ose humbjen e investitorit. Shpërndarjet e marra nga i investuari zvogëlojnë vlerën kontabël të investimit. Rregullime të vlerës kontabël mund të jenë gjithashtu të nevojshme për ndryshimet në interesin proporcional të investitorit në i investuari, të cilat vijnë nga ndryshimet në kapitalin neto të të investuarit të cilat nuk ishin njohur në fitimin ose humbjen e të investuarit. Ndryshime të tilla përfshijnë ato që rezultojnë nga rivlerësimi i tokave, ndërtesave, makinerive e pajisjeve dhe nga diferencat e kursit të këmbimit. Pjesa e investitorit në ndryshime të tilla njihet direkt në kapitalin neto të investitorit.
- 12 Kur ekzistojnë të drejta votuese potenciale, pjesa e investitorit tek fitimi ose humbja e të investuarit dhe tek ndryshimet në kapitalin e të investuarit përcaktohen në bazë të interesave aktuale te pronësisë dhe nuk reflekton përdorimin apo konvertimin e mundshëm të të drejtave votuese potenciale.

## Aplikimi i metodes se kapitalit neto

- 13 **Nje investim në një pjesëmarrje kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto me përjashtim të rasteve kur:**
- (a) **investimi klasifikohet si i mbajtur për shitje në përputhje me IFRS 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*;**
  - (b) **zbatohet përjashtimi sipas paragrafit 10 të SNK 27, i cili lejon një shoqëri mëmë e cila zotëron njëkohësisht një investim në një pjesëmarrje që të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara; ose**
  - (c) **kur zbatohen të gjitha sa vijojnë:**
    - (i) **Investitori është një filial plotësisht i zotëruar, ose është një filial pjesërisht i zotëruar i një njesie tjetër ekonomike dhe pronarët e tjerë të saj, duke përfshirë ata të cilët përndryshe nuk kanë të drejtë të votojnë, janë informuar mbi, dhe nuk kanë kundërshtime kundrejt mos aplikimit të metodës së kapitalit neto;**
    - (ii) **Instrumentet e borxhit ose kapitalit të investitorit nuk tregtohen në një treg publik (një bursë lokale ose e huaj ose treg jashtë burse, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale);**
    - (iii) **investitori nuk ka depozituar dhe as nuk është në proces të depozitimit të pasqyrave të saj financiare në një komision letrash me vlerë ose një organizatë tjetër rregullatore për qëllimet e emetimit të ndonjë klasë të instrumentave në një treg publik; dhe**
    - (iv) **shoqëria mëmë përfundimtare ose e ndërmjetme e investitorit prodhon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim nga publiku, të cilat janë në koherencë me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.**
- 14 **Investimet e përshkruara në paragrafin 13(a) kontabilizohen në përputhje me IFRS 5.**
- 15 Kur një investim në pjesëmarrje i klasifikuar më parë si i mbajtur për shitje, nuk i përmbush më kriteret për t'u konsideruar si i tillë, atëherë ai do të kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto që prej datës kur është klasifikuar si i mbajtur për shitje. Pasqyrat financiare për periudhat që nga fillimi i klasifikimit si i mbajtur për shitje duhet të rregullohen si rezultat i këtij riklasifikimi.
- 16 [Fshirë]
- 17 Njohja e të ardhurave në bazë të shpërndarjeve të marra mund të mos jetë një vlerësim i mjaftueshëm i të ardhurave të fituara nga një investitor prej një investimi në një pjesëmarrje, sepse shpërndarjet e marra mund të kenë lidhje të vogël me performancën e pjesëmarrjes. Meqënëse investitori ka influencë domethënëse mbi pjesëmarrjen, investitori ka një interes në performancën e pjesëmarrjes dhe, si rezultat i kësaj, edhe në kthimin nga investimi i tij. Investitori kontabilizon këtë interes duke zgjeruar objektin e pasqyrave të tij financiare për të përfshirë pjesën e vet të fitimit ose humbjes të një pjesëmarrjeje të tillë. Si rezultat, zbatimi i metodës së kapitalit neto jep një raportim më informativ të aktiveve neto dhe fitimit ose humbjes të investitorit.
- 18 **Një investitor ndalon përdorimin e metodës së kapitalit neto nga data kur ndalon së pasuri influence domethënëse mbi një pjesëmarrje dhe i kontabilizon investimet në përputhje me SNK 39 prej kësaj date, me kusht që pjesëmarrja të mos bëhet një filiale apo një sipërmarrje e përbashket sipas përkufizimit në SNK 31.**
- 19 **Vlera kontabël e investimit në datën kur ndalon së qëni një pjesëmarrje konsiderohet si kostoja e saj në matjen fillestare si një aktiv financiar në përputhje me SNK 39.**
- 20 Shumë prej procedurave të nevojshme për zbatimin e metodës së kapitalit neto janë të ngjashme me procedurat e konsolidimit të përshkruara në SNK 27. Për më tepër, konceptet bazë të procedurave të përdorura në kontabilizimin e blerjes së një filiali përdoren gjithashtu në kontabilizimin e blerjes së një investimi në një Pjesëmarrje.
- 21 Pjesa e një grupi në një Pjesëmarrje është agregatja e zotërimeve në atë pjesëmarrje nga shoqëria mëmë dhe filialet e saj. Zotërimet e tjera nga ana e vetë pjesëmarrjeve ose të sipërmarrjeve të përbashkëta të grupit nuk konsiderohen për këtë qëllim. Kur një pjesëmarrje zotëron filiale, pjesëmarrje, apo sipërmarrje të përbashkëta, fitimet ose humbjet dhe aktivet neto të marra në konsideratë kur zbatohet metoda e kapitalit neto janë ato që janë njohur në pasqyrat financiare të pjesëmarrjes (duke përfshirë pjesën e pjesëmarrjes në fitimet ose humbjet dhe aktivet neto të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të saj), pas ndonjë rregullimi të nevojshëm në përputhje me politikat kontabël uniforme (shiko paragrafet 26 dhe 27).
- 22 Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga transaksionet 'drejt majës' dhe 'drejt fundit' midis një investitori (duke përfshirë filialet e konsoliduara të tij) dhe një pjesëmarrjeje njihen në pasqyrat financiare të investitorit vetëm deri në masën e interesave të investitoreve të pa lidhur në pjesëmarrjen në fjalë. Transaksionet 'drejt majës' janë, për shembull, shitjet e aktiveve nga një pjesëmarrje tek investitori. Transaksionet "drejt fundit" janë, për

shembull, shitjet e aktiveve nga një investitor tek pjesëmarrja. Pjesa e investitorit në fitimet dhe humbjet e pjesëmarrjes që rezulton nga këto transaksione eliminohet.

23 23 Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto nga data në të cilën ajo bëhet një pjesëmarrje. Në kohën e blerjes së investimit çdo diferencë midis kostos së investimit dhe pjesës së investitorit në vlerën e drejtë neto të aktiveve, pasiveve, dhe pasiveve të kushtëzuara të identifikueshme, të pjesëmarrjes kontabilizohet në përputhje me SNRF 3 *Kombinime Biznesi*. Pra:

(a) emri i mirë në lidhje me një pjesëmarrje përfshihet në vlerën kontabël të investimit. Por amortizimi i emrit të mirë nuk lejohet dhe për pasojë nuk përfshihet në përcaktimin e pjesës së investitorit në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes.

(b) çdo tepriçë e pjesës së investitorit në vlerën e drejtë neto të aktiveve, pasiveve dhe pasiveve të kushtëzuara të identifikueshme të pjesëmarrjes, mbi koston e investimit, përjashtohet nga vlera kontabël e investimit dhe përfshihet si e ardhur në përcaktimin e pjesës së investitorit në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes në periudhën në të cilën investimi është blerë.

Gjithashtu bëhen rregullimet e duhura të pjesës së investitorit në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes pas blerjes për të kontabilizuar, për shembull, amortizimin e aktiveve të amortizueshme duke u bazuar në vlerën e drejtë të tyre në datën e blerjes. Në mënyrë të ngjashme, bëhen rregullime të duhura të pjesës së investitorit në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes pas blerjes për humbjet nga zhvlerësimet që njihen nga pjesëmarrja, si p.sh. për emrin e mirë ose toka, ndërtesa, dhe makineri e pajisje.

24 **Investitori në aplikimin e metodës së kapitalit neto përdor pasqyrat financiare më të fundit të disponueshme të një pjesëmarrjeje. Kur datat e raportimit të investitorit dhe të pjesëmarrjes janë të ndryshme, pjesëmarrja përgatit, për përdorimin nga investitori, pasqyra financiare për të njëjtën datë si pasqyrat financiare të investitorit përveç rastit kur kjo nuk është praktikisht e mundshme.**

25 **Kur, në përputhje me paragrafin 24, pasqyrat financiare të një pjesëmarrjeje të përdorura në zbatimin e metodës së kapitalit neto përgatiten për një datë raportimi të ndryshme nga ajo e pasqyrave të investitorit, bëhen rregullime për efektin e transaksioneve të rëndësishme ose ngjarjeve që ndodhin ndërmjet asaj date dhe datës së pasqyrave financiare të investitorit. Në çdo rast, ndryshimi ndërmjet datës së raportimit të pjesëmarrjes dhe asaj të investitorit duhet të jetë jo më shumë se tre muaj. Gjatësia e periudhave të raportimit dhe çdo ndryshim në datat e raportimit duhet të jetë i njëjtë nga periudha në periudhë.**

26 **Pasqyrat financiare të investitorit përgatiten duke përdorur politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe ngjarje në rrethana të ngjashme.**

27 Nëse një pjesëmarrje përdor politika kontabël të ndryshme nga ato të investitorit për transaksione të ngjashme dhe ngjarje në rrethana të ngjashme, bëhen rregullime që politikat kontabël të pjesëmarrjes të jenë në konformitet me ato të investitorit kur pasqyrat financiare të pjesëmarrjes përdoren nga investitori në aplikimin e metodës së kapitalit neto.

28 Nëse një pjesëmarrje ka gjendje në qarkullim aksione preferenciale kumulative, të cilat zotërohen nga palë të treta të ndryshme nga investitori dhe i ka klasifikuar ato si kapital, investitori llogarit pjesën e tij të fitimeve ose humbjeve pas rregullimit të bërë për dividendët e aksioneve të tilla, pavarësisht nëse dividendët janë deklaruar apo jo.

29 Nëse pjesa e investitorit në humbjet e një pjesëmarrjeje është e barabartë ose e kalon interesin e tij në pjesëmarrje, investitori ndalon së njohuri pjesën e tij në humbjet e mëtejshme. Interesi në një pjesëmarrje është vlera kontabël e investimit në pjesëmarrje sipas metodës së kapitalit neto bashkë me çdo interes afatgjatë i cili, në thelb, është pjesë e investimit neto të investitorit në atë pjesëmarrje. Për shembull, një element, për të cilin nuk është planifikuar po edhe as nuk pritet të bëhet pagesa në të ardhmen e afërt, në thelb, është një rritje e investimit të njesisë ekonomike në atë pjesëmarrje. Zëra të tillë mund të përfshijnë, aksione preferenciale dhe llogari të arkëtueshme afatgjata ose huatë por nuk përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare, llogaritë e pagueshme tregtare apo ndonjë llogari të arkëtueshme afatgjatë për të cilin ekziston kolateral i mjaftueshëm, si psh huatë e siguara. Humbjet e njohura sipas metodës së kapitalit neto që tejkalojnë investimin e investitorit në aksionet e zakonshme zbatohen në komponentët e tjerë të interesit të investitorit në një pjesëmarrje sipas një radhe në të kundërtët të prioritetit të tyre (dmth prioritetit në likuidim).

30 Pasi interesi i investitorit zvogëlohet në zero, humbjet shtesë provizionohen, dhe njihet një detyrim deri në masën që investitori ka detyrime ligjore ose konstruktive ose deri në masën e pagesave të bëra në emër të pjesëmarrjes. Nëse pjesëmarrja më pas raporton fitime, investitori rifillon njohjen e pjesës që i takon nga keto fitime vetëm pasi pjesa e tij e fitimeve bëhet e barabartë me pjesën e humbjeve të panjohura.

## Humbje Zhvlerësimi

- 31 Pas aplikimit të metodës së kapitalit neto, duke përfshirë njohjen e humbjeve të pjesëmarrjes në përputhje me paragrafin 29, investitori zbaton kërkesat e SNK 39 për të përcaktuar nëse është e nevojshme të njohë ndonjë humbje zhvlerësimi shtesë në lidhje me investimin neto të investitorit në pjesëmarrje.
- 32 Investitori zbaton gjithashtu kërkesat e SNK 39 për të përcaktuar nëse ndonje humbje zhvlerësimi shtesë duhet të njihet në lidhje me interesin e investitorit në pjesëmarrje i cili nuk është pjesë e investimit neto si dhe për të përcaktuar shumën e humbjes nga zhvlerësimi.
- 33 Për arsye se emri i mirë i përfshirë në vlerën kontabël të një investimi në një pjesëmarrje nuk njihet individualisht, ai nuk testohet individualisht për zhvlerësim duke zbatuar kërkesat për testimin e zhvlerësimit e emrit të mirë në SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*. Në vend të kësaj, e gjithë vlera kontabël e investimit testohet sipas SNK 36 për zhvlerësim, duke krahasuar, shumën e rikuperueshme (më e madhja mes vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes) me vlerën kontabël, sa herë që zbatimi i kërkesave në SNK 39 tregon se investimi mund të jetë zhvlerësuar. Në përcaktimin e vlerës në përdorim të investimit, një njësi ekonomike vlerëson:
- (a) pjesën që i takon në vlerën aktuale të flukseve të ardhme të vlerësuar të mjeteve monetare që priten të gjenerohen nga pjesëmarrja, duke përfshirë flukset monetare nga aktivitetet operative të pjesëmarrjes dhe të ardhurat nga shitja e mundshme e investimit; ose
  - (b) vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të përlogaritura që priten të vijnë nga dividendët që preten të merren nga investimi si dhe nga shitja e mundshme e tij.
- Nëse bëhen supozimet e duhura, të dyja metodat japin të njëjtin rezultat.
- 34 Shuma e rikuperueshme e një investimi në pjesëmarrje vlerësohet për çdo pjesëmarrje, përveç rastit kur pjesëmarrja nuk gjeneron hyrje të mjeteve monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë mjaft të pavarura nga flukset e gjeneruara nga aktivet e tjera të njësisë ekonomike.

## Pasqyrat financiare individuale

- 35 Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafet 37-42 të SNK 27.
- 36 Ky Standard nuk përcakton cilat njësi ekonomike përgatisin pasqyra financiare individuale të vlefshme për përdorim publik.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 37 Duhet të bëhet dhënia e informacioneve shpjeguese vijuese:
- (a) vlera e drejtë e investimeve në pjesëmarrje për të cilat ka kuotime publike të çmimeve;
  - (b) informacion financiar i përmbledhur i pjesëmarrjeve, duke përfshirë shumat agregate të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe fitimet ose humbjet;
  - (c) arsyet se përse supozimi se një investitor nuk ka influencë domethënëse nuk qëndron nëse investitori zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet filialeve, me pak se 20 përqind të votave apo fuqisë votuese potenciale të të investuarit por përsëri arrin në përfundimin se ai ka influencë të konsiderueshme;
  - (d) arsyet për të cilat supozimi se një investitor ka influencë domethënëse nuk qëndron nëse investitori zotëron, në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet filialeve, 20 përqind ose më shumë të votave ose fuqisë votuese potenciale të të investuarit, por arrin në përfundimin se ai nuk ka influencë të konsiderueshme;
  - (e) data e raportimit të pasqyrave financiare të një pjesëmarrjeje, kur pasqyra të tilla financiare janë përdorur në zbatimin e metodës së kapitalit neto dhe janë përgatitur në një datë raportimi ose për një periudhë raportimi që është e ndryshme nga ajo e investitorit, dhe arsyeja për përdorimin e një date raportimi ose periudhë të ndryshme;
  - (f) natyra dhe shkalla e çdo kufizimi të rëndësishëm (psh që rezulton nga marrëveshje huamarrjeje ose kërkesa rregullatore) në aftësinë e pjesëmarrjes për të transferuar fonde tek investitori në formën e dividendëve të pagueshëm në vlera monetare, ose për ripagesa të huave ose paradhënieve;

- (g) pjesa e panjohur e humbjeve të një pjesëmarrjeje, si për periudhën ashtu dhe në mënyrë kumulative, nëse një investitor ka ndërprerë njohjen e pjesës që i takon atij në humbjet e një pjesëmarrjeje;
  - (h) fakti që një pjesëmarrje nuk është kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit neto në përputhje me paragrafin 13; dhe
  - (i) informacion financiar i përmbledhur i pjesëmarrjeve, qoftë individualisht ose në grupe, të cilat nuk janë kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit neto, duke përfshirë shumat e aktiveve totale, pasiveve totale, të ardhurat si dhe fitimin ose humbjen.
- 38 Investimet në pjesëmarrje të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto klasifikohen si aktive afatgjata. Pjesa e investitorit në fitimin ose humbjen e një pjesëmarrjeje të tillë, dhe vlera kontabël e këtyre instrumenteve, duhet të jepet veçmas. Pjesa e investitorit në çdo operacion të ndërpreë të një pjesëmarrjeje të tillë duhet të jepet gjithashtu veçmas.
- 39 Pjesa që i takon investitorit në ndryshimet e njohura në mënyrë direkte në kapitalin e një pjesëmarrjeje njihet drejtpërsëdrejti në kapital nga investitori dhe duhet të jepen në pasqyrën e ndryshimeve në kapitali siç kërkohet nga SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.
- 40 Në përputhje me SNK 37 *Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara* investitori jep informacion shpjegues për:
- (a) pjesën e tij të pasiveve të kushtëzuara në një pjesëmarrje të marra përsiper bashkarisht me investitorë të tjerë; dhe
  - (b) ato pasive të kushtëzuara të cilat lindin sepse investitori është përgjegjës për të gjitha ose për një pjesë të pasiveve të një pjesëmarrjeje.

## Data e hyrjes në fuqi

---

- 41 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## Tërheqja e prononcimeve të tjera

---

- 42 Ky Standard zëvendëson SNK 28 *Kontabiliteti për Investimet në Pjesëmarrje* (i rishikuar në 2000).
- 43 Ky Standard zëvendëson Interpretimet e mëposhtme:
- (a) KIS-3 *Eliminimi i Fitimeve dhe Humbjeve të Përealizuara në Transaksionet e Investimeve me Pjesëmarrje*
  - (b) KIS-20 *Metoda Kontabël e Kapitalit Neto - Njohja e Humbjeve*; dhe
  - (c) KIS-33 *Konsolidimi dhe metoda e kapitalit - Të drejtat Votuese Potenciale dhe Shpërndarja e Interesave të Pronësisë*.